



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr 357/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej znj. Kimete Gashi-Kryetare, znj. Nita Bejta- Anëtare, z. Vedat Poterqoi - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik(duke ju referuar më poshtë si OE) : “HARST Group ” sh.p.k. Rr. 7 Marsi p.n Suharekë , kundër njoftimit për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit: “Rikonstruimi dhe mirëmbajtja e institucioneve arsimore” me nr. prokurimi: 616-22-4320-5-2-1 dhe numër te brendeshem:616 22 063 521, aktivitet ky i prokurimit i iniciuar dhe i zhvilluar nga autoriteti kontraktues (duke ju referuar më poshtë si AK) Komuna e Prishtinës, më datën: 04.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa e OE “HARST Group ” sh.p.k. Rr. 7 Marsi p.n Suharekë , për Lotin qe OE ka parashtruar ankesë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit: “Rikonstruimi dhe mirëmbajtja e institucioneve arsimore” me nr. prokurimi: 616-22-4320-5-2-1 dhe numër te brendeshem:616 22 063 521, aktivitet ky i prokurimit i iniciuar dhe i zhvilluar nga AK) Komuna e Prishtinës.

- II. **ANULOHET**, vendimi i AK-së njoftimit për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit: “Rikonstruimi dhe mirëmbajtja e institucioneve arsimore” me nr. prokurimi: 616-22-4320-5-2-1 dhe numër te brendeshem:616 22 063 521, aktivitet ky i prokurimit i iniciuar dhe i zhvilluar nga AK Komuna e Prishtinës, aktiviteti i prokurimit në fjalë kthehet në Rivlerësim.
- III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.
- V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “HARST Group ” sh.p.k. Rr. 7 Marsi p.n Suharekë , bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.
- VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues “HARST Group ” sh.p.k. Rr. 7 Marsi p.n Suharekë , si pal e pa knaqr me daten 18.08.2022 ka parshtruar ankese anese kjo e protokolluar nga OSHP me numer 353/2022,ankese kjo e parashtruar kunder vendimit te AK-së - Njoftimit për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit: “Rikonstruimi dhe mirëmbajtja e institucioneve arsimore” me nr. prokurimi: 616-22-4320-5-2-1 dhe numër te brendeshem:616 22 063 521, aktivitet ky i prokurimit i iniciuar dhe i zhvilluar nga AK Komuna e Prishtinës, duke pretenduar që AK ka vepruar në kundërshtim me:

Neni 1 i LPP-së

Neni 6 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 61 i LPP-së

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 23.08.2022, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 02.09.2022, në raportin e ekspertizës ka deklaruar:

OE ankues i pa kënaqur me vendimin e autoritetit kontraktues, ka paraqitur ankese ne OSHP me arsyetim se OE i rekomanduar për kontratë për disa pozicione te para masës ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 1

OE ankues pretendon se OE i shpallur fitues është i pa përgjegjshëm pasi që ka dorëzuar ofertë jo –normalisht të ulët.

OE ankues se tek Grupi i Pare i punëve tek paramasa konkretisht pozicioni nr. 4 për këtë pozicion OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmim fiktiv jo real i cili nuk asocion me çmimet reale të tregut.

Gjithashtu pozicioni me nr.12, është jo normalisht i ulët pasi që nuk ka mundësi që të realizohet ky pozicion me këtë çmim.

Po ashtu pozicioni nr.6, çmimi i ofertuar tejkalon koston vetëm për punë dore pa përfshirë koston e materialit që janë 100 herë më të mëdha se sa çmimi i ofertuar.

Po ashtu pozicionet 8,9,10 kanë çmime jo normalisht të ulëta të cilat nuk përkojnë me çmimet r tregut as 20%.

Tek grupi i 4 i paramases pozicioni 1, OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmim 1Euro/m2, ndërsa çmimi real i tregut është 18 Euro/m2.

Pozicioni nr.2-kostoja minimale për këtë pozicion duke mos përfshi edhe koston e kallupimit, vuarjes në vepër dhe mirëmbajtja e tij është 124Euro/m³ që ka dallim me çmimin e ofruar 2480%.

Pra duke u bazuar vetëm në shembujt e krahasimit të çmimeve shihet qartë se çmimet e ofruara nga OE N.N.P “EURO CONSTRUCTION” janë jo reale dhe kanë dallim të madh me çmimet momentale të tregut dhe po ashtu dallim të lartë edhe me çmimet e tregut që kanë qenë para inflacionit të vitit të kaluar.

Arsyetimi i AK-së në kërkesën për sqarime ndaj AK-së për çmime jo normalisht të ulëta , OE i propozuar për kontratë ka rritur garancionin e ekzekutimit në vlerë 30% është i pa bazë, pasi që nuk duhet të jetë interesi i AK-së që të rritet sigurimi i ekzekutimit por që pala të shpërblehet me kontratë të kryej punimet sipas kontratës në afat, dhe është e pa mundur që OE i propozuar për kontratë të ia dalë në përmbylljen e projektit me çmimet e ofertuara.

Pas analizimit të dokumenteve të ofruar në E prokurim për këtë aktivitet të prokurimit, eksperti shqyrtues sqaron se në E prokurim AK-ja nuk ka ngarkuar ndonjë dokument që i ka kërkuar sqarime OE të rekomanduar për kontratë për çmime jo normalisht të ulëta.

Me dt. 25.08.2022, eksperti shqyrtues përmes një kërkesë me shkrim ka kërkuar informata nga AK-ja, lidhur me kërkesën e AK-së ndaj OE të rekomanduar për kontratë si dhe përgjigjen e OE të rekomanduar për kontratë ndaj AK-së.

Në po të njëjtën datë pra me dt.25.08.2022, AK-ja më është përgjigjur duke ofruar si dëshmi edhe përgjigjen e OE të rekomanduar për kontratë.

Në bazë të shkresës së ofruar AK-ja ka kërkuar sqarime për OE të rekomanduar për kontratë me pyetjen si në vijim: *“Autoriteti Kontraktues ju kërkon sqarim me konfirmim përmes pdf file që ju të garantoni se do të merrni përsipër sigurimin e ekzekutimit në vlerë prej 30% të vlerës së përgjithshme të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Rikonstruimi dhe mirëmbajtja e institucioneve arsimore - kulmeve - Lot 3, ku vlera e ofertës suaj është e ulët: 59,40 EUR”.*

Ndërsa OE i rekomanduar për kontratë i përgjigjet AK-së si në vijim:

DEKLARATE

Unë I nënshkruari Defrim Morina nën përgjegjësinë e Administratorit të kompanisë N.N.P. "EURO Construction" Fsh. Ratkoc-Rahovec me nr biznesi 810740945 deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se jemi të gatshëm të garantojmë dhe të ua sjellim sigurinë e ekzekutimit në vlerë prej 30% ashtu siç e kemi kërkuar lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Rikonstruimi dhe mirëmbajtja e institucioneve arsimore - kulmeve - Lot 3, ku vlera e ofertës sonë është: 59,40 EUR.

Autoriteti Kontraktues, nuk ka kërkuar sqarime për pozicione të cilat duket të jenë çmime të ulëta, mirëpo ka kërkuar sigurimin e ekzekutimit në vlerë 30%. Andaj eksperti shqyrtues mendon që AK-ja nuk ka respektuar në tersi Nenit 61 të LPP-së dhe Rregullores për tender jo normalisht të ulët, ku është e specifikuar qartë se si të veprojnë AK-ja në rast kur duket se ka të bëjë me një tender ose ndonjë pozicion të tenderit jo normalisht të ulët.

Eksperti shqyrtues, rekomandon që gjatë procesit të rivlerësimit AK-ja të kërkojë sqarime për pozicionet të cilat pretendohen për çmime jo normalisht të ulëta ashtu siç parashihet në nenin 61 të LPP-së si dhe të veprojnë në harmoni me nenin 3 dhe 4 të rregullave për tender jo normalisht të ulët.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE "HARST Group" Suharekë, të aprovohet si pjesërisht e bazuar, dhe rekomandon që lënda të kthehet në Rivlerësim.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 02 shtator 2022 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti kontraktues nuk ka kthyer ndonjë përgjigje, se pajtohet apo jo me mendimin e ekspertit të OSHP-së.

Operatori ekonomik me datën 05 shtator 2022 ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca e shqyrtimit kryesor është mbajtur me datën: 03 tetor 2022, ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, njoftimi për dhënie të kontratës B58 , kërkesa për rishqyrtim, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron;

Lidhur për të gjitha pretendimet ankimore të OE ankues, paneli shqyrtues i klasifikon si të pabazuara dhe mbështetet në raportin e përpiluar nga eksperti shqyrtues të caktuar nga OSHP, detyrë e të cilit ka qenë që të shqyrtohen të gjitha pretendimet ankimore dhe mendimi i tij profesional është që ankesa e OE ankues të aprovohet e pabazuar ndërsa aktiviteti të kthehet në rivlerësim.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si

më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryetare e PSH-së
Znj. Kimete Gashi



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Komuna e Prishtinës

1x1 OE "HARST Group" sh.p.k. Rr. 7 Marsi p.n Suharekë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.